



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.992/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Dren Rogova dhe Saranda Sheremeti-Bogaj anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “A...” Sh.p.k me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve SCLR Partners, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1977/18, të dates 06.10.2020 në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09.02.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1977/18, të dates 06.10.2020, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1977/18, të dates 06.10.2020, është aprovuar kërkesëpadia e paditësit “AS

Alberti” Sh.p.k me seli në Prishtinë, si e bazuar, ashtu që është anuluar aktvendimi i të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, nr. 07.3/1782,1850 i datës 16.07.2018, dhe është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit “A...” Sh.p.k me seli në Prishtinë, t’ia pranoj vlerën e transaksionit realisht të paguar sipas faturës përcjellëse për mallin lëndor sipas DUD-ve R-11386,R-11385,R-11389 të datës 18.11.2014, R-11826, R-11823,R-11824 të datës 02.12.2014 duhet t’ia kthej mjetet e papaguara më tepër paditësit në emër të taksave doganore importuese në vlerë prej 2,959.38€ (dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë euro e tridhjet e tetë cent).

Kundër këtij aktgjykimi e paditura Dogana e Kosovës, ka ushtruar ankesë për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, vërteimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës LKA. Me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar me ligj, dhe priset aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë A.nr.1977/18, të datës 06.10.2020, si dhe të refuzon si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, dhe të lenë në fuqi vendimin e kontestuar, ose ta kthej në rivendosje.

Paditësi ka paraqit përgjigje në ankesë edhe ka propozuar të refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar ndaj aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë A.nr.1977/18 datës 06.10.2020, dhe të vërtetoi si të bazuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë Departamenti për Cështje Administrative Divizioni Fiskal A.nr.1977/18 datës 06.10.2020, sipas të cilit aktgjykimi është aprovuar si e bazuar kërkespadia e paditësit dhe është anuluar vendimi i të paditurës dhe është obliguar e paditura që paditësi t’ia kthejë mjetet monetare të paguar më tepër gjatë zhdoganimit në shumën e përgjithshme prej 2,959.38 euro.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 81.G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar, nr.07.3/1782,1850 i datës 16.07.2018 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë “A...” Sh.p.k me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit nr.R-11386, R-11385, R-11389 të datës 18.11.2014, R-11826, R-11823,R-11824 të datës 02.12.2014 të lëshuar nga Zyra Doganore Dheu i Bardhë, si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e Doganës së Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit, nr.07.3/1782 i datës 16.07.2018, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, në seancën e shqyrtimit kryesor e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin padinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke e anuluar aktvendimin e kontestuar dhe obliguar të paditurën Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit “AS Alberti” Sh.p.k me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumën 2,959.38€(dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë euro e tridhjet e tetë centë), të paguar më tepër, në emër të taksave doganore importuese.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi aktvendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, vendosi që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit. Me arsyetim se e paditura nuk i ka përfill rekomandimet e dhëna nga vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, që të shqyrtoj pretendimet e paditësit lidhur me dokumentacionin përcjellës i mallit lëndor, në aspektin ligjor. Po ashtu e paditura ka qenë e detyruar ti mbështesë me dispozita ligjore vlerësimet se dokumentacioni përcjellës i mallit është i pamjaftueshëm dhe në këtë drejtim gjykata konstaton se e paditura nuk ka arritur të dëshmojë qartë se ku konsistojnë ato prova bindëse të cilat e bëjnë këtë dokumentacion të pakompletuar, jo origjinal dhe të pa harmonizuar më vlerën e mallit të paguar ose të pagueshme për mallin lëndor kontestuese. Ndër të tjera ka theksuar se e paditura edhe në procedurën e rivendosjes nuk i ka vërtetuar faktet esenciale ka nxjerrë konkluzion jo të drejtë në pikëpamje të gjendjës faktike, nuk ka zbatuar drejt dispozitat e legjislacionit doganor, andaj gjykata këtë konflikt administrativ posedon prova të mjaftueshme të vendos në mënyrë meritore në përputhje të nenit 81.1 par 2 pika

2.2 të Ligjit nr.04/L-102 dhe neni 43 par 3,46 parag 4 si dhe 67 i LKA-së. Po ashtu ka shtuar se gjykata nuk mund të pajtohet me qëndrimin juridik të dhënë në vendimin kontestues nga e paditura, për arsye se paditësi ka paraqitur gjithë dokumentacionin e nevojshme gjatë fazës së zhdoganimit të mallit lëndor, faturën si dhe transaksionet bankare i cili dëshmon cmimin e blerjes realisht të paguar për mallin lëndor, të cilët dokumente përputhen plotësisht në kuptim të vlerës së transaksionit për pagesën e faturës së mallit lëndor në kuptim të nenit 33 të KDA-së. Kështu gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se e paditura gabimisht gjendjen faktike dhe si pasojë e kësaj edhe ka aplikuar gabimisht drejtën materiale kur ka aplikuar nenin 35 të KDA-së, pasi nëse do të konstatonte drejtë gjendjen faktike në bazë të kontaktimeve të lartëcekura, atëherë e paditura do të duhej aplikonte vlerën e transaksionit bankar për mallin lëndor në bazë të nenit 33 të KDA-së. Krejt në fund ka theksuar se aplikimi i metodës së 6 të vlerësimit në vështrim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave është veprim i cili bie ndesh me dispozitat e nenit 33-34 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109 për arsye se para se të aplikohet metoda e 6 e vlerësimit duhet të jepen arsyet dhe provat për ta konstatuar vlerën e mallit lëndor dhe dokumentacionin e dorëzuar me kërkesë nga paditësi si fatura e mallit, transaksioni bankar, e të cilat dokumente janë në tërësi të harmonizuar në kuptim të vlerës së mallit në përputhje me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për impementimin e KDA. Andaj dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e pranona dhe kjo gjykatë si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron me që gjykata ka shqyrtuar padinë,

fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe KDAK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gjithashtu kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të bazuara. Sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktvendimi i organit administrativ i të paditurës nuk është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji i kësaj gjykate, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, bazuar në shkresat e lëndës, po ashtu nuk ka gjetur asnjë provë konkrete që dëshmon konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë. Meqë e paditura nuk ka dëshmuar me prova konkrete se paditësi ia ka paguar eksportuesit të mallit vlerën më të vogël se sa vlera e deklaruar me DUD-in kontestues dhe faturën përcjellëse të mallit lëndor. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LPA, LKA, Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, Kodi nr.03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-099.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË

K.DH.SH.II.nr.992/22, me datën 09.02.2023

**Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri**